

# DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

## BULETINI INFORMATIV

SHKURT 2023



Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas z.Qirici, mori pjesë në programin “Unë dhe e Drejta Ligjore” në Radio Televizionin Shqiptar. Në këtë program u ndanë me dëgjuesit risitë e sistemit të ndihmës juridike falas, analiza vjetore e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe rezultatet e arrira



U zhvillua pranë Qendrës Multifunktionale Nishtulla një takim me qytetarët e kësaj zone, kryesisht të komunitetit rom. Gjatë këtij takimi u promovua ndihma juridike falas, si edhe u konfirmua një vazhdimësi bashkëpunimi ndërinstytucional për referimin e rasteve.

U zhvillua procedura e hedhjes së shortit për përgatitjen e listës dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative për vitin 2023.



Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Korçë mori pjesë në takimin me temë “Aksesi në sistemin e drejtësisë dhe garantimi i sigurisë së viktimave të dhunës në familje, në kuadrin e hartës së re gjyqësore dhe riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”



Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Berat zhvilloi një takim ndërgjegjësues në qytetarë të komunitetit rom dhe egjiptian

